



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr.520/4 Prot

Tiranë, më 26.4.2023

VENDIM

Nr.18, datë 26.4.2023

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja, znj. (në vijim “ankuesja”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) Formularin e Ankesës nr. 520 prot., datë 06.03.2023, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krim të Organizuar (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, me anë të kërkesës së datës 23.02.2023, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni në lidhje me:

1. Një kopje të plotë të akteve dhe provave gjyqësore të dosjes me nr. Akti, 34 datë 30.10.2015, të paraqitura nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, për procedimin penal nr. 245, me datë 16.11.2013, për veprën penale të "Trafikimit të narkotikëve" të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal;
2. Një kopje të plotë të dosjes gjyqësore me nr. Akti 34, datë 30.10.2015, e regjistruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë me datë 16.11.2013, si procedimi penal nr. 245, për veprën penale të "Trafikimit të narkotikëve" të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal;

3. *Një kopje të vendimit nr. Vendimi 69, datë 18.05.2016, me Kryesuese gjyqtaren Iliriana Olldashi, të dosjes gjyqësore me nr. Akti 34, në ngarkim të të pandehurve*

, me akuzën e kryerjes së veprës penale të "Trafikimit të narkotikëve", të kryer në bashkëpunim dhe të mbetur në tentative, të parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 22 të Kodit Penal.

Autoriteti Publik, nëpërmjet e-mail-it datë 28.02.2023, dërguar nga znj. _____ me detyrë specialiste e marrdhënieve me publikun në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krim të Organizuar, ka kthyer përgjigje duke ftuar ankuesen pranë ambienteve të Autoritetit Publik me qëllim njohjen me dokumentacionin e kërkuar prej saj, si dhe evidentimin e akteve të cilat ankuesja kërkonte një kopje.

Në datën 01.03.2023, ankuesja është paraqitur pranë ambienteve të Autoritetit Publik, ku është njohur me dokumentacionin e kërkuar, si dhe ka evidentuar aktet për të cilat kërkonte të merrte një kopje, takim për të cilin është mbajtur edhe procesverbali nr. 213/1 prot., datë 01.03.2023, nga ana e Autoritetit Publik.

Në mungesë të marrjes së kopje të akteve të evidentuara dhe të një shpjegimi të mëtejshëm nga Autoriteti Publik, ankuesja, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit, Formularin e Ankesës nr. 520 prot., datë 06.03.2023, duke kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e informacionit/dokumentacionit të cituar si më sipër.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa është në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe ankuesja legjitimohet në kërkimin e saj.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Zyra e Komisionerit nëpërmjet shkresës nr. 520/1 prot., datë 10.03.2023, drejtuar Autoritetit Publik dhe për dijeni ankueses, ka kërkuar të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Me shkresën nr. 714/1 prot., datë 17.03.2023, Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: “*...Në vijim, mbështetur në dispozitat e ligjit të sipërcituar, strukturat përgjegjëse pranë GJKKO shqyrtuan dhe analizuan me kujdes kërkesën e gazetares (OCCRP), e cila kërkonte kopje të akteve të dosjeve gjyqësore që administrohen pranë GJKKO-së. Në këto kushte, përveç respektimit të parashikimeve të dispozitave të ligjit nr. 119/2014, kërkesa e saj u trajtua në konformitet edhe me parashikimet e neneve 103, 104 dhe 105 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), ku*

përcaktohen në mënyrë të qartë rastet e ndalimit të publikimit të aktit, shkeljes së ndalimit të publikimit dhe marrjes së kopjeve, ekstrakteve dhe vërtetimeve... Në këtë kontekst, vlen të theksohet fakti se, në kushtet kur, në rastin konkret aktet e kërkuara nga kërkuesja konsistojnë në akte gjyqësore të marra në shqyrtim në dhomë këshillimi, si dhe akte që i kthehen prokurorit e që procedimin e çojnë në fazën e hetimit paraprak, zbatohen në mënyrë të menjëhershme edhe kufizimet e vendosura nga ligjvënësi nëpërmjet parashikimit të nenit 103 të KPP, ku përcaktohet shprehimisht se: 1. Ndalohet publikimi, qoftë dhe i pjesshëm i akteve sekrete që lidhen me çështjen ose vetëm i përmbajtjes së tyre ndërmjet shtypit ose informacionit masiv. 2. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve jo sekrete deri në përfundimin e hetimeve paraprake. 3. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve të shqyrtimit gjyqësor kur gjykimi bëhet me dyer të mbyllura. Ndalimi i publikimit hiqet kur plotësohen afatet e caktuara me ligj për arkivat e shtetit ose kur ka kaluar afati prej dhjetë vjetësh nga data që vendimi ka marrë formën e prerë, por me kusht që publikimi të ketë autorizuar nga Ministri i Drejtësisë”.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i Autoritetit Publik nuk është në përputhje me dispozitat e LDI, si dhe detyrimet që burojnë nga ky i fundit.

Bazuar në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: “Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”. Në kuptim të këtij parashikimi, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krim të Organizuar është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundur realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në pikën 1 të nenit 1 përcakton se: “Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike”. Në këtë kuptim, çdo autoritet publik pavarësisht nëse është në cilësinë e “prodhuesit” apo “mbajtësit” të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.

Refuzimi i dhënies së informacionit me pretendimin e Autoritetit Publik, se shkel dispozitat e parashikuara në nenin 103 të Kodit të Procedurës Penale, pasi çështja për të cilën është kërkuar informacioni nga ankuesja, siç vetë Autoriteti Publik në shkresën nr. 714/1 prot., datë 17.03.2023 ka theksuar “...aktet e kërkuara nga kërkuesja konsistojnë në akte gjyqësore të marra në shqyrtim në dhomë këshillimi...”, vlerësohet se nuk është i mbështetur në ligj. Parashikimet e nenit 103 të Kodit të Procedurës Penale, i cili shprehet se: “1. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve sekrete që lidhen me çështjen ose dhe vetëm i përmbajtjes së tyre nëpërmjet shtypit ose informacionit masiv. 2. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve josekrete deri në përfundimin e hetimeve

paraprake. 3. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve të shqyrtimit gjyqësor kur gjykimi bëhet me dyer të mbyllura. Ndalimi i publikimit hiqet kur plotësohen afatet e caktuara me ligj për arkivat e shtetit ose kur ka kaluar afati prej dhjetë vjetësh nga data që vendimi ka marrë formën e prerë, por me kusht që publikimi të jetë autorizuar nga Ministri i Drejtësisë.”, nuk mund të aplikohen në rastin konkret pasi çështja është gjykuar në dhomë këshillimi dhe jo me dyer të mbyllura siç shprehimisht kërkon dispozitivi i nenit 103 pika 3. Gjykimi me dyer të mbyllura kryhet vetëm sipas urdhërimeve të nenit 340 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon rastet specifike të gjykimit me dyer të mbyllura dhe në zbatim të pikës 3 të nenit 340, gjykata duhet të shprehet me vendim për zhvillimin e gjykimit me dyer të mbyllura.

Edhe pretendimi i Autoritetit Publik se “...akte që i kthehen prokurorit e që procedimin e çojnë në fazën e hetimit paraprak...”, nuk qëndron, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me Vendimin nr. 56260-00242-00-2017 i Regj. Themeltar, nr. 00-2022- 1100 i Vendimit, të datës 15.09.2022, është shprehur mbi çështjen penale me nr. 56260-00242-00-2017, të cilës i përkasin aktet e kërkuara nga ankuesja, duke ezauruar në këtë mënyrë të gjitha shkallët e gjykimit dhe rrjedhimisht, dhënia e këtij informacioni nuk shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë për parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale, ashtu si edhe në barazinë e palëve në proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor, kufizime këto, të parashikuara në gërmat b) dhe dh) të nenit 17, të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Për sa me sipër Autoriteti Publik, në shqyrtimin e kërkesës për informim të ankueses, duhet të kishte marrë parasysh vetëm parashikimet e pikës 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit “Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”. Autoriteti Publik duhet të kishte vlerësuar kufizimin e pjesëve të cilat sipas gjykimit të tij i nënshtrohen kufizimeve të trajtuara më sipër sipas pikës 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, duke vënë në dispozicion të kërkuarit pjesën tjetër të tij.

Ndryshe nga sa parashikon LDI, konstatohet se, Autoriteti Publik në asnjë moment nuk ka argumentuar apo cituar se në cilën pikë të nenit 17 të LDI e mbështet qëndrimin e tij lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar. Pasi, është ky nen i cili parashikon mundësinë e kufizimit e të drejtës për informim, shkaqet dhe arsyet që mund të çojnë një autoritet për të kufizuar të drejtën për informim, si dhe rastet përjashtimore nga ky rregullim.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se Autoriteti Publik, në trajtimin e kërkesës për informim dhe dhënien e kopjeve të materialeve të evidentuara gjatë takimit të mbajtur pranë arkivës së Autoritetit Publik në datën 01.03.2023, nuk mund të refuzonte në tërësi dhënien e informacionit të kërkuar, por duhet të kishte marrë parasysh, në harmoni me njëra-tjetrën parashikimet e nenit 17 të LDI, ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit Nr.15, datë

23.12.2011 “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor”, duke vendosur në dispozicion ato materiale mbi të cilat nuk ka një shkak ligjor për kufizimin.

Theksojmë se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksonimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në pikën 3 të nenit 3 të LDI parashikohet se, “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së znj. _____, nr. 520 prot., datë 06.03.2023, ndaj Autoritetit Publik, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krim të Organizuar, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 06.03.2023, konkretisht: “1. Një kopje të plotë të akteve dhe provave gjyqësore të dosjes me nr. Akti, 34 datë 30.10.2015, të paraqitura nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, për procedimin penal nr. 245, me datë 16.11.2013, për veprën penale të "Trafikimit të narkotikëve" të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal; 2. Një kopje të plotë të dosjes gjyqësore me nr. Akti 34, datë 30.10.2015, e regjistruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë me datë 16.11.2013, si procedimi penal nr. 245, për veprën penale të "Trafikimit të narkotikëve" të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal; 3. Një kopje të vendimit nr. Vendimi 69, datë 18.05.2016, me Kryesuesen gjyqtaren Iliriana Olldashi, të dosjes gjyqësore me nr. Akti 34, në ngarkim të të pandehurve _____, me akuzën e kryerjes së veprës penale të "Trafikimit të narkotikëve", të kryer në bashkëpunim dhe të mbetur në tentative, të parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 22 të Kodit Penal.”, në përputhje me parashikimet e pikës 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” si dhe duke respektuar anonimizimin sipas udhëzimit

- nr. 15, datë 23.12.2011 “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor”, brenda datës 04.5.2023.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
 4. Ky vendim u shpall sot në datë 26.4.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi